



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET ORGANIZATËS BOTËRORE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE, DREJTORISËSË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE DHE SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale ("WIPO") me selinë e saj në Gjenevë, Zvicër, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Shkolla e Magjistraturës me vendndodhje në Tiranë, Shqipëri (më tej referuar individualisht si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët").

Duke marrë në konsideratë misionin e WIPO, kushtuar për të udhëhequr zhvillimin e një ekosistemi global të pronësisë intelektuale të balancuar dhe efektive për të promovuar inovacionin dhe kreativitetin për një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme;

Duke marrë në konsideratë misionin e DPPI (Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale), kushtuar forcimit të sistemit të të Drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë;

Duke marrë në konsideratë misionin e Shkollës së Magjistraturës kushtuar trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve ligjorë/këshilltarëve dhe avokatëve të shtetit.

Theksimit të rëndësisë së bashkëpunimit ndërmjet Palëve në fushën e administrimit gjyqësor të pronësisë intelektuale në realizimin e përfitimeve të sistemit të pronësisë intelektuale dhe në përputhje me normat përkatëse ndërkombëtare dhe parimet e njohura botërisht;

Kanë rënë dakord të hyjnë në një Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejshëm "MOU") (Memorandum Mirëkuptimi), si vijon:

NENI 1: QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Qëllimi i këtij memorandumi është të zhvillojë bashkëpunimin dhe aktivitetet e përbashkëta midis WIPO, DPPI dhe Shkollës së Magjistraturës me synimin për të forcuar sistemin gjyqësor dhe shërbimet për mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale.

NENI 2: FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Me synimin për të arritur qëllimin e identifikuar në nenin 1, Palët do të përpiqen të ndërmarrin një sërë aktivitete për ndarjen e informacionit dhe ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë:

- shkëmbimin e përvojave gjyqësore;
- bashkëpunimi në ngritjen e kapaciteteve gjyqësore, duke përfshirë ndjekjen penale të krimit të pronësisë intelektuale (PI);
- hulumtime të përbashkëta për çështjet e pronësisë intelektuale;
- shkëmbimin e informacionit për vendimet gjyqësore;
- promovimi i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve; dhe
- çdo formë tjetër bashkëpunimi që mund të bihet dakord reciprokisht nga Palët.

NENI 3: SHKËMBIMI I EKSPERIENCAVE GJYQËSORE

Palët do të bashkëpunojnë për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave gjyqësore nëpërmjet konferencave, seminareve ose takimeve për gjyqtarët që trajtojnë çështjet në lidhje me pronësinë intelektuale.

NENI 4: RITJIA E KAPACITETEVE GJYQËSORE

4.1 Palët do të bashkëpunojnë në zbatimin e aktiviteteve të vazhdueshme të trajnimit mbi PI për autoritetet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Programi i CJE (Edukimi i Vazhdueshëm Gjyqësor) ka si objektiva të tij:

- a) Rritjen e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës për të ofruar aktivitete të vazhdueshme trajnimi mbi PI-në që u përgjigjen nevojave të identifikuara nëpërmjet vlerësimit të rregullt;
- b) Të zhvillojë kapacitetin dhe aftësitë e gjyqtarëve për të gjykuar në mënyrë efikase mosmarrëveshjet e PI (zgjidhje më e shpejtë, me vendime të cilësisë dhe parashikueshmërisë më të lartë) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe duke marrë parasysh strategjitë kombëtare të PI, si dhe qëllimet dhe prioritetet zhvillimore;
- c) U mundëson gjyqtarëve të rinj të fitojnë një kuptim bazë të fushës komplekse të PI dhe gjyqtarëve me përvojë të marrin informacion të përditësuar mbi statutet dhe zhvillimet e reja të PI.

NENI 5: KËRKIM I PËRBASHKËT PËR ÇËSHTJET E PRONËSISË INTELEKTUALE

Palët do të bashkëpunojnë në kërkime të përbashkëta mbi çështjet aktuale të pronësisë intelektuale. Forma shtesë të bashkëpunimit të ndërsjellë mund të bien dakord sa herë që gjykohet e përshtatshme për të arritur objektivin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi (MOU).

NENI 6: SHKËMBIMI I TË DHËNAVE PËR PARAQITJEN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Palët do të nxisin paraqitjen e vendimeve kryesore në fushën e pronësisë intelektuale duke shkëmbyer të dhëna nëpërmjet bazës së të dhënave të vendimeve të WIPO Lex.

NENI 7: ZGJIDHJA ALTERNATIVE E MOSMARRËVESHJEVE

Palët janë të informuara rreth zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, duke përfshirë shërbimet e ofruara nga Qendra e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit WIPO, si një mjet privat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pronësisë intelektuale. Në veçanti, neutraliteti, fleksibiliteti dhe ekspertiza e ofruar nga ndërmjetësimi, arbitrazhi ose përcaktimi i ekspertëve mund t'i përshtaten nevojave të palëve në mosmarrëveshje të tilla.

NENI 8: ZBATIMI DHE VLERËSIMI

8.1 Zbatimi i Memorandumi të Mirëkuptimit është subjekt i disponueshmërisë së burimeve – duke përfshirë buxhetin, burimet njerëzore dhe/ose IT – të secilës prej Palëve, dhe proceseve të tyre përkatëse të miratimit.

8.2 Përveçse kur është rënë dakord ndryshe, secila Palë do të mbulojë shpenzimet e veta në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të përmendura në këtë Memorandum.

8.3 Palët do të takohen periodikisht për të rishikuar dhe vlerësuar aktivitetet e koordinimit dhe bashkëpunimit të ndërmarra sipas këtij Memorandumi, dhe për të bërë rekomandimet e duhura për to.

NENI 9: HYRJA NË FUQI, NDRYSHIMET DHE PËRFUNDIMI

9.1 Memorandumi i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e tij nga të dyja Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

9.2 Çdo dispozitë e këtij Memorandumi Mirëkuptimi (MOU) mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, të shprehur me shkrim.

9.3 Memorandumi i Mirëkuptimit mund të ndërpritet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve ose nga njëra Palë duke i dhënë palës tjetër njoftim paraprak me shkrim prej tre muajsh. Përfundimi i kësaj

Marrëveshjeje nga njëra nga Palët nuk do të ndryshojë detyrimet e lidhura më parë ose që linden nga aktivitetet e nisura dhe të kryera sipas kushteve të Marrëveshjes, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

NENI 10: ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që lind ose ka të bëjë me këtë Memorandum Mirëkuptimi, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negociatave me mirëbesim ndërmjet Palëve.

NENI 11: PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Asgjë në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet që i janë dhënë WIPO-s, si një organizatë ndërkombëtare dhe agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara.

BAZUAR NË KËTË MEMORANDUM, të nënshkruarit, të autorizuar sipas ligjit, e nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi në gjashtë kopje origjinale, tre në gjuhën angleze dhe tre në gjuhën shqipe, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhje apo ndryshimi midis versionit anglisht dhe shqip, do të mbizotërojë versioni në anglisht.

Për Shkollën e Magjistraturës

Për Drejtorinë e Përgjithshme të
Pronësisë Industriale (DPPI)

Për Organizatën Botërore
të Pronësisë Intelektuale
(WIPO)



Arben Rakipi
Drejtor i Përgjithshëm

Datë: 3.7.2023

Vendi: TIRANE



Rovena Beqira
Drejtor i Përgjithshëm

Datë: 10.7.2023

Vendi: GENEVA

Marco M. Alemán
Asistent Drejtor i
Përgjithshëm
Sektori i PI dhe Ekosistemit
të Inovacionit

Datë: 10.7.2023

Vendi: GENEVA



MEMORANDUM OF UNDERSTANDING BETWEEN THE WORLD INTELLECTUAL PROPERTY ORGANIZATION, GENERAL DIRECTORATE OF INDUSTRIAL PROPERTY AND THE MAGISTRATE SCHOOL OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

The World Intellectual Property Organization ("WIPO") having its headquarters in Geneva, Switzerland, the General Directorate of Industrial Property (GDIP) and the Magistrate School located in Tirana, Republic of Albania (hereinafter referred to individually as "Party" and jointly as the "Parties"),

Considering the mandate of WIPO, dedicated to leading the development of a balanced and effective global intellectual property ecosystem to promote innovation and creativity for a better and more sustainable future;

Considering the mandate of GDIP, dedicated to strengthening the system of industrial property rights in the Republic of Albania;

Considering the mandate of the Magistrate School dedicated to initial and continuous training of judges, prosecutors, legal advisors/councilors and state advocates;

Emphasizing the importance of cooperation between the Parties in the area of the judicial administration of intellectual property in realizing the benefits of the intellectual property system, and in accordance with the relevant international norms and universally recognized principles;

Have agreed to enter into a Memorandum of Understanding (hereinafter referred to as the "MOU"), as follows:

ARTICLE 1: PURPOSE OF THE MOU

The purpose of this MOU is to develop cooperation and joint activities between WIPO, GDIP and the Magistrate School with a view to strengthening the judicial system and services for intellectual property protection and enforcement.

ARTICLE 2: AREAS OF COOPERATION

With a view to achieving the purpose identified in Article 1, the Parties will endeavor to undertake a number of information sharing and capacity building activities, including:

- the exchange of judicial experiences;
- collaboration in judicial capacity building, including the prosecution of intellectual property (IP) crime;
- joint research on intellectual property issues;
- the exchange of information on judicial decisions;
- the promotion of alternative dispute resolution; and
- any other form of cooperation as may be mutually agreed upon by the Parties.

ARTICLE 3: EXCHANGE OF JUDICIAL EXPERIENCES

The Parties will cooperate to facilitate the exchange of judicial experiences through conferences, seminars or meetings for judges handling cases relating to intellectual property.

ARTICLE 4: JUDICIAL CAPACITY BUILDING

4.1 The Parties will cooperate in the implementation of continuous training activities on IP for the judiciary of the Republic of Albania.

4.2 The CJE program has as its objectives to:

- a) Enhance the capacity of the Magistrate School to deliver continuous training activities on IP that respond to the needs identified through regular assessment;
- b) Develop the capacity and skills of judges for adjudicating IP disputes efficiently (more prompt resolution, with decisions of higher quality and predictability) in accordance with the applicable legal framework, and taking into account national IP strategies, and developmental goals and priorities;
- c) Enable new judges to gain an initial understanding of the complex field of IP, and experienced judges to receive updated information on new IP statutes and developments.

ARTICLE 5: JOINT RESEARCH ON INTELLECTUAL PROPERTY ISSUES

The Parties will cooperate in joint research on topical intellectual property issues. Additional forms of mutual cooperation may be agreed upon whenever deemed appropriate to achieve the objective of this MOU.

ARTICLE 6: DATA EXCHANGE FOR THE DISSEMINATION OF JUDICIAL DECISIONS

The Parties will promote dissemination of leading judgments in the field of intellectual property by exchanging data through the WIPO Lex-Judgments database.

ARTICLE 7: ALTERNATIVE DISPUTE RESOLUTION

The Parties recognize the potential usefulness of alternative dispute resolution, including the services offered by the WIPO Arbitration and Mediation Center, as a private means of resolving intellectual property disputes. In particular, the neutrality, flexibility and expertise offered by mediation, arbitration or expert determination can suit the needs of parties to such disputes.

ARTICLE 8: IMPLEMENTATION AND EVALUATION

8.1 The implementation of the MOU is subject to the availability of resources – including budget, human and/or IT resources – of each of the Parties, and to their respective internal approval processes.

8.2 Unless otherwise agreed, each Party shall bear its own costs in connection with the implementation of the activities referred to in this MOU.

8.3 The Parties shall meet periodically to review and evaluate coordination and cooperation activities undertaken under this MOU, and to make appropriate recommendations thereon.

ARTICLE 9: ENTRY INTO FORCE, MODIFICATIONS AND TERMINATION

9.1 The MOU will enter into force upon its signature by both Parties and will remain in force for an indefinite period of time.

9.2 Any provision of this MOU may be modified by mutual consent of the Parties, expressed in writing.

9.3 The MOU may be terminated by mutual consent of the Parties or by one Party giving the other prior written notice of three months. Termination of this MOU by one of the Parties shall not alter obligations previously entered into or arising from activities initiated and conducted under the terms of the MOU, unless otherwise agreed

ARTICLE 10: SETTLEMENT OF DISPUTES

Any dispute arising out of or relating to this MOU shall be resolved amicably through negotiations in good faith between the Parties.

ARTICLE 11: PRIVILEGES AND IMMUNITIES

Nothing in or relating to this MOU shall be deemed a waiver of any of the privileges and immunities accorded to WIPO, as an international organization and specialized agency of the United Nations.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned, duly authorized therefor, have signed this MOU in six original copies, three in English and three in Albanian, all texts being equally authentic. In case of discrepancies or differences of interpretation between the English and Albanian versions, the English version shall prevail.

For the Magistrate School


For the General Directorate of
Industrial Property (GDIP)

For the World Intellectual
Property Organization
(WIPO)



Date: 3.7.2023

Place: TIRANA



Date: 10.7.2023

Place: GENEVA

Marco M. Alemán
Assistant Director General
IP and Innovation
Ecosystems Sector

Date: 10.7.2023

Place: GENEVA